

**THE ONLY SPACE WHERE “OLD WORDS” LIVE FREELY IS THE
FIELD OF LITERATURE
E VETMJA HAPËSIRË KU GJALLOJNË LIRSHËM “FJALËT PLAKA”
ËSHTË FUSHA E LETËRSISË**

Zarije NUREDINI¹

^{1*} Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: zarije.nuredini@unite.edu.mk

Abstract

All the written literature, whether the Albanian or the World one, is filled with folk lexicon and obsolete words, in order to put it in the service of its own style, or to keep alive that great linguistic wealth. A lot of dissertations by various researchers have been written on the rich lexicon full of archaisms and neologisms by writers who have played an important role in the great world literature, thus giving extraordinary importance to the selection of a particular and rare lexicon. This was undoubtedly considered and continues to be considered as part of its systematic values. Such linguistic works on the use of this particular lexicon can also be done on the works of our traditional or contemporary literature.

In order to illustrate the thesis that our writers, each of them, including the most famous names in our entire history of literature, such as Ismail Kadare, have "dipped the bread" on that inexhaustible fountain of the nation and in those words that have been extracted (passivized) long time ago from the everyday colloquial discourse, I have analyzed only two writers, Jakov Xoxa and Murat Isaku whose works are enriched with many obsolete words or archaisms. It enriches the language, restores to it many forgotten words, or as Pjetër Bogdani used to say, *obsolete and forgotten words*, or adds new words to the language.

Keywords: *archaisms, neologisms, folk lexicon, written literature, dialect flow.*

Përmbledhje

E tërë letërsia e shkruar, qoftë ajo botërore a shqiptare, thith në trupin e saj nga leksiku popullor, nga fjalët e vjetra, herë për ta vënë në shërbim të stilit vetanak, e herë për ta mbajtur gjallë atë pasuri të madhe gjuhësore. Disertacione të tëra nga studiues të ndryshëm janë bërë vetëm mbi leksikun e pasur me arkaizma e neologjizma të shkrimtarëve që kanë zënë vend në letërsinë e mëdha botërore, duke i dhënë kështu rëndësi të jashtëzakonshme qëmtimit të një leksiku të veçantë e të rrallë nga ana e tyre. Kjo pa dyshim cilësohet dhe vazhdon të cilësohet edhe sot si pjesë e vlerave sistematike të saj. Punime të atilla gjuhësore mbi shfrytëzimin e këtij leksiku të veçantë mund të bëhen edhe mbi veprat e letërsisë sonë, qoftë të asaj të traditës, apo bashkëkohores. Sa për ta ilustruar tezën se shkrimtarët tanë, secili prej tyre, përfshirë edhe emrat më në zë të tërë historisë sonë të letërsisë, siç është, për shembull, Ismail Kadareja, e kanë “ngjyer bukën” në atë gurrë të pashtershme të popullit dhe në ato fjalë që janë nxjerrë (janë pasivizuar) kahmoti nga ligjërimi bisedimor i përditshëm, kam marrë për analizë vetëm dy shkrimtarë, të cilët në veprat e tyre kanë përdorur shumë fjalë të vjetra apo arkaizma: Jakov Xoxën dhe Murat Isakun. Ajo e pasuron gjuhën, i rikthen asaj shumë fjalë që janë harruar, apo sikurse e thoshte Pjetër Bogdani, *fjalë plaka e të harrueme*, ose i shton gjuhës fjalë të reja.

Fjalët kyçe: *arkaizmat, neologjizmat, leksiku popullor, letërsia e shkruar, prurjet dialektore.*

1. Hyrje

Interesimi i letrarëve për thesarin gojor popullor, në një rën anë dhe për traditën e kultivuar letrare në anën tjetër, për krijimet popullore të të gjitha viseve shqiptare dhe për shkrimet e Lekë Matrëngës, Frano Bardhit, Pjetër Budit, Jul Varibobës, Pjetër Bogdanit sa mund të quhet interesim për vazhdimësinë e dëshiruar të kulturës, po aq mund të quhet interesim për vazhdimësinë e gjuhës shqipe në kohë e në hapësirë.

E tërë letërsia e shkruar, qoftë ajo botërore a shqiptare, thith në trupin e saj nga leksiku popullor, nga fjalët e vjetra, herë për ta vënë në shërbim të stilit vetanak, e herë për ta mbajtur gjallë atë pasuri të madhe gjuhësore. Disertacione të tëra nga studiues të ndryshëm janë bërë vetëm mbi leksikun e pasur me arkaizma e neologjizma të shkrimtarëve që kanë zënë vend në letërsinë e mëdha botërore, duke i dhënë kështu rëndësi të jashtëzakonshme qëmtimit të një leksiku të veçantë e të rrallë nga ana e tyre. Kjo pa dyshim cilësohet dhe vazhdon të cilësohet edhe sot si pjesë e vlerave sistematike të saj.

Punime të atilla gjuhësore mbi shfrytëzimin e këtij leksiku të veçantë mund të bëhen edhe mbi veprat e letërsisë sonë, qoftë të asaj të traditës, apo bashkëkohores. Sa për ta ilustruar tezën se shkrimtarët tanë, secili prej tyre, përfshirë edhe emrat më në zë të tërë historisë sonë të letërsisë, siç është, për shembull, Ismail Kadareja, e kanë “ngjyer bukën” në atë gurrë të pashtershme të popullit dhe në ato fjalë që janë nxjerrë (janë pasivizuar) kahmoti nga ligjërimi bisedimor i përditshëm, kam marrë për analizë vetëm dy shkrimtarë, të cilët në veprat e tyre kanë përdorur shumë fjalë të vjetra apo arkaizma: Jakov Xoxën dhe Murat Isakun.

Ajo e pasuron gjuhën, i rikthen asaj shumë fjalë që janë harruar, apo sikurse e thoshte Pjetër Bogdani, *fjalë plaka e të harrueme*, ose i shton gjuhës fjalë të reja. Letërsia, gjithashtu, nuk mban qëndrim të rreptë ndaj shprehjeve dialektore apo krahinorizmave dhe nuk bëhet vetëm pre e kallëpeve të standardit gjuhësor. Kjo sepse letërsia, veçanërisht proza, ngjall një kohë, kurse çdo kohë e ka gjuhën e vet, e cila dallon nga gjuha e një kohe tjetër. Këtë më së miri e ka ilustruar Umberto Eko, i cili gjatë shkrimit të romaneve të tij, paraprakisht, ka studiuar leksikun e përdorur gjatë asaj periudhe, sikurse është rasti me romanin *Emri i trëndafilut* apo *Baudolino*. Gjuha e përdorur gjatë periudhës së Mesjetës është, njëkohësisht, gjuha e romaneve të tij.

Sa herë që flitet për mjeshtërinë artistike të çdo shkrimtari, në radhë të parë, duhet të vlerësohen: gjuha e veprës së tij, fjalori, frazeologjia, përzgjedhja e elementeve të të folurit popullor, ngjyresa krahinore dhe përgjithësisht prurjet dialektore që përzgjidhen për t'i shtënë në indin e gjuhës e të stilit letrar krijimtarinë e shkrimtarëve të tjerë shqiptarë. Për pasurinë dhe larminë e madhe leksikore dhe frazeologjike shquhet proza e Jakov Xoxës, sidomos e romanit “Lumi i vdekur”, kurse Ismail Kadareja dallohet për zotësinë e tij të rrallë për ta qëmtuar fjalën e bukur krahinore, duke iu qasur fjalorit të pasur burimor të të gjitha trojeve shqiptare, si për shembull fjalëve të anëve verilindore, në përputhje me tematikën e romaneve të tij të këtyre viseve.

Gjithashtu, në letërsinë shqipe vlen të përmenden disa shkrimtarë që kanë vepruar ngjashëm sikurse Eko, Kadare dhe Xoxa, ndër të cilët veçojmë: Agron Tufën, Vath Koreshin, por edhe shkrimtarin e këtyre trevave, Murat Isakun, opusi letrar i të cilit, krahas prurjeve artistike dhe estetike shquhet edhe për gjuhën e veçantë, plot magji dhe me nuancime të shumta semantike. Shkrimtari i njohur Xhabir Ahmeti thekson se Murat Isaku “*na i zbuloi bukuritë e gjuhës shqipe dhe na e zbuloi mrekullinë e letërsisë*” (Ahmeti, Xhabir, 2007, f. 31).

Studiues të shumtë të veprës së tij kanë vënë re se opusi i tij letrar karakterizohet edhe për pasurinë gjuhësore, e cila shprehet si në aspektin narrativ të narratorit, gjithashtu edhe në gjuhën e personazheve. Rëndom, fjalët e vjetruara nuk bëjnë pjesë në leksikun e gjuhës e sotme standarde, por në letërsi përdoren me vlera stilistike të veçanta.

Të moçme janë disa fjalë që janë shkruar në veprat e autorëve të vjetër por sot nuk i gjejmë në përdorim, si: ager (gomar), përderës (lypës), hijezë (ombrellë), ujanë (oqean), regjëni (mbretëri), regjënoj (mbretëroj), gjellë (jetë) etj.

2. Përfundimi

Kjo shtresë e vjetruar e leksikut të gjuhës shqipe shfrytëzohet sidomos për të sjellë tonin solemn ose të rëndë, pikërisht sepse këto mjete vijnë jo nga përdorimi i gjallë, por nga një kulturë e lashtë, bartin atmosferën e një kultivimi të ngurtësuar si lapidar, madje dhe nga një përfytyrim i mitologjizuar prej largësisë së kohës. (Hamiti, 2018-193). I. Kadare e jep këtë ide poetikisht:

*Nga kaosi i gërmadhave
që koha pas e la
u ngrit e na erdhi
kjo fjalë: Embëtha*

Siç e përmendëm edhe më lart se fjalët e vjetra apo arkaizmat janë pjesë e leksikut edhe të Xoxës. Për shkak të ripërtrirjes historike, e cila është pjesë e arkaizmave, po ashtu edhe e dialektizmave kanë disa funksione. Ata shfrytëzohen që të paraqitet koha dhe atmosfera historike, të prezantohet koloriti i rrethit dhe për ta karakterizuar gjuhën e personazhëve. (Xh. Lloshi, 1999, f. 106) ajo vërtetohet edhe në gjuhën e romanit të Xoxës. Fjalë arkaike është edhe emri i mëparshëm i banorëve të Myzeqesë, si emër i përgjithshëm *lalëria*, përderisa gjinia femërore *laleshat*, përmban dallime kuptimore.